V E N D I M
Nr.687, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Korçës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Korçës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 4250 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 5 318 450 (pesë milionë e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Korçës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 122 000 (njëqind e njëzet e dy mijë) lekë.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
7. Pagesat e pronarëve të shpronësuar të kryhen nga Bashkia e Korçës.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE
NË BASHKINË KORÇËS

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Myqereme Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
2	Ridvan Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
3	Selaidin Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
4	Klarens Stefan Kote	1062.5	1251.4	1329612.5
	Shuma	4250		5318450